

POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1

Dyshohet se brenda ka mbetur një roje, familjarët presin pranë qendrës tregtare ku ka rënë zjarri në Tiranë

(Emri)

2

'Perla' e Lulzim Bashës: Kam nisur të lexoj Leon Tolstoin që kur isha 4 vjeç, kur isha student në Holandë kam ndihmuar Shqipërinë duke i dërguar para

3

Zjarri në qendrën tregtare në Tiranë, pas 5 orësh shtëllungat e tymit vijonë të dalin nga magazina (VIDEO)

4

Pse askush s'e njih emrin e kësaj gruaje?

5

Zjarr në magazinën e një qendre tregtare në Tiranë, dyshohet se roja është brenda! Drejtori i zjarrfikësës:

Aktualitet

Agjenti i infiltruar zbërthen grupin! Policia kap 2 trafikantët me 4 mina me telekomandë në makinë (EMRAT)

Një agjent i infiltruar në grupin e trafikantëve të minave me shpërthim në distancë, ka çuar në arrestimin në flagrancë të dy personave në momentin që do tentonin të shisnin minat me telekomandë.

Sh

Redaksia

16 Mars, 09:26 | Përditësimi i fundit: 16 Mars, 13:03

A

A

DURRËS- Një agjent i infiltruar në grupin e trafikantëve të minave me shpërthim në distancë, ka çuar në arrestimin në flagrancë të dy personave në momentin që do tentonin të shisnin minat me telekomandë.

Agron Gurakuqi 46 vjeç dhe Bledian Greca 35 vjeç u vunë në pranga në Mëzes të Tiranës, në operacionin e koduar "Distanca. Aty, policia i sekuestroi 4 mina me telekomandë, të cilat ndodheshin në makinën që drejtonte Agron Gurakuqi dhe që dyshohet se shitja e tyre do të kryhej në Durrës. Burime nga grupi hetimor thonë se të arrestuarit nuk i kanë bërë publik emrat e personave që do t'u shisnin minat.



Sh

LEXO EDHE:

Ngjarjet e fundit kriminale, policia 'blindon' Durrësin! Kontrolle për kapjen e personave në kërkim edhe në Elbasan

Të prangosurit janë me precedentë të mëparshëm penalë për ndërtim pa leje dhe armëmbajtje pa leje. Gurakuqi dhe Greca punonin sëbashku si për gjetjen e materialeve që shërbejnë për prodhimin e minave ashtu dhe për montimin e tyre të cilat i shisnin deri në 3 mijë euro copa. Kjo është ngarkesa e pestë që kapet në Durrës në harkun kohor të 1 viti.



Minat e sekuestruara

Njoftimi i policisë:

Finalizohet operacioni policor i koduar "Distanca".

Operacioni i zhvilluar strukturat e DVP Durrës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Sekuestrohen 4 mina me telekomandë.

Arrestohen në flagrancë 2 shtetas me precedent të mëparshëm penal, të cilët do i shisnin minat kundrejt fitimit deri në 3000 euro për një copë.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Durrës, në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e prodhimit dhe trafikimit të minave me telekomandë, bazuar edhe në informacionet e marra në rrugë operative se 2 shtetas po tentonin të trafikonin mina me shpërthim në distancë, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "Distanca", në kuadër të të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit:

A. G., 46 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për veprën penale "Ndërtim pa leje";

B. G., 35 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për veprën penale "Armëmbajtja pa leje".

Gjatë kontrollit fizik, shtetasit A. G., shërbimet e Policisë i kanë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 4 mina me telekomandë, të cilat këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, do i shisnin me çmimin 2000 deri në 3000 euro.

Po gjatë operacionit, në banesën e shtetasit B. G., shërbimet e Policisë kanë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një sasi të vogël lënde narkotike cannabis sativa.

Nën drejtimin e Prokurorisë vijon puna për evidentimin dhe kapjen edhe të personave të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprime të mëtejshme.

Be.K./B.K./Shqiptarja.com

TAG: dures mina me telekomande Agron Gurakuqi Bledian Gresa

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

COM

Sondazhi i ditës:

A mendoni se në zgjedhjet e 25 prillit vendoset fati i reformës në drejtësi?

PO

JO

Nuk e di

Komento

Lajme të tjera

Aktualitet



Nis vaksinimi i pedagogëve në universitetin 'Aleksandër Xhuvani', zv/rektori: Jemi pro për ta bërë vaksinën! Kemi hartuar lista sipas dëshirës

24 Mars, 21:38

Aktualitet



Makina më të cilën udhëtonte u përplas me një kamion, humb jetën shqiptarja në Itali (FOTO)

24 Mars, 20:51

Aktualitet



Dyshohet se brenda ka mbetur një roje, familjarët presin pranë qendrës tregtare ku ka rënë zjarri në Tiranë (Emri)

24 Mars, 20:27


Aktualitet



Zjarri në magazinën e qendrës tregtare në Tiranë, dyshohet se roja të jetë brenda ambienteve

24 Mars, 19:56

Aktualitet



Manastirliu thirrje për të punuar në Spitalin e Fierit: Aplikoni, vlerësimi i kandidatëve do bëhet nga një komision ad-hoc

24 Mars, 19:16

Aktualitet



'Kam qenë 21 ditë në koma', Bujar Qamili rrëfen betejën e vështirë me COVID: Dola pozitiv pas konfimit në Tiranë

24 Mars, 19:15

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju